



BashkAjetesa ekonomi-arsim e domosdoshme

Anita Kadriu | 27-05-2011 10:43 CET

Like

Nxjerra e kuadrove të Universitetit të Prishtinës (UP) në përputhje me kërkesat e ekonomisë së vendit, do të jetë prioriteti i përkrahjes ndërkombëtare dhe përkushtimit vendor për periudhën e ardhshme trejcejare.

Për të zbatuar këtë strategji, UP, universitet ndërkombëtare partner dhe Komisioni Evropian, të enjten kanë bërë promovimin e projektit "Kompetenca në UP (CUP)", i cili financohet nga KE përmes programit TEMPUS.

Ky projekt, sipas përfaqësuesve të UP-së, KE-së dhe universiteteve partnere, synon përmirësimin e lindjes në dërmjet kompetencave (shkaktësive) të zhvilluara nga institucion i arsimit të lartë dhe kërkesat e tregut të punës.

Them elimi i Qendrës së Kompetencës dhe Observimit (COC), instalimi i sistemeve të Këshillimit të studentëve në 32 lokacione strategjike të UP-së, kryerja e analizave të diturisë të bazuar në dy pilot-programe të studimeve që të shërbjnë më në vonë si shembuj për këtë praktikë etj., janë paraparë si objektiv a kryesore të këtij projekti.

Rektori i Universitetit të Prishtinës (UP), Muje Rugova, ka thënë se një ndër sfidat më të rëndësishme që përballet shoqëria kosovare është reformimi i UP-së në përputhje me nevojat e tij, procesin e Bolonjës dhe zhvillimin në arsimin e lartë. "Katalogu i zhvilluar i kompetencës dhe sistemi i informimit do ta bëjnë edukimin në universitet më transparent dhe ta lehtësoj qasjen në të. Do ta lidhë fushën e punës me arsimin nëpërmjet Tempus- projektit dhe do ta përkrahë zhvillimin e mësimit gjatë gjithë jetës".

Ndërkëq, koordinatori i këtij projekti në UP, proektori për marrëdhënie ndërkombëtare Naser Mrasori, ka përmendor se pikat kryesore në të cilat mbështetet UP për të arritur ndërkombëtarizimin është integrimi i Kosovës në hapësirën e Unionit Evropian, harmonizimi i programeve sipas Bolonjës, implementimi i krediteve, pjesëmarrja në konferencën ndërkombëtare, mobiliteti i studentëve dhe stafit akademik, mësimi në distancë... Ai ka thënë se UP tanë ka realizuar 145 marrëveshje me universitete ndërkombëtare.

Kurse drejtori i organizatës për ndihmë arsimit "Wus Austria", But Dedaj, ka thënë se çdo ditë e më shumë universitet po kërkojnë formë sesi të shesin produktet e veta si dhe me çfarë dije t'i brumosin kuadrot e veta që të kenë hapësirë dhe sukses në treg. Ai ka bërë me dije se fondet për universitet publike janë duke u zgjedhur nga qeveritë e shumë vendev e dhe universitetet po sfidohen që të krijojnë fonde vetë.

Si fakultete pilote të këtij projekti janë përgjedhur Fakulteti Ekonomik, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë si dhe Fakulteti i Arkitekturës, kurrikulet e të cilave do të shikohen dhe vlerësohen nëse janë të përshtatura apo jo me tregun e punës. Është paralajmëruar që çdo fakultet të ketë qendra të kompetencës.

Metodologjia e krijuar brenda këtij projekti do të bazohet në transferimin e njohurive nga universitetet partner të BE dhe të adaptuar në bazë të kërkesave vendore. Qendra COC gjithashtu do të observojë dhe monitorojë zhvillimet kombëtare dhe evropiane në fushat respektive.

UP ka gjithsej 48.732 studentë, prej tyre në bachelor studiojnë 38.533 studentë, në master 10.047 dhe në doktorat 152 studentë. Në promovim kanë marrë pjesë edhe përfaqësues të Universitetit grant mbajtës të projektit nga Graci.



NGA RUBRIKA

- » Serbia nuk do t'i njohë vulat e Republikës së Kosovës
- » Westerelle: Statusi i dhe kufijtë, çështje të mbyllura
- » Për një të ardhme të fuqishme
- » Shumë prizrenas heqin dorë nga shtetësia e Kosovës
- » Autostrada e parë vetëm në hartë
- » Riatdhesimi i dhimbshëm
- » Buhler i përgjigjet Brigitte Bardot
- » EULEX, pajiset me 6 autoblinda
- » Vlasi: Ndaja nuk është opsjon real
- » Lunacek: S'mjafton Miladiqi për BE
- » Konsullata, nga 1 qershor i lëshojnë dokumente personale
- » Vija e kuqe, nuk diskutohet!
- » Rugovasit për Qeverinë: Pa ne mos flitni për kufirin
- » Shqipja në Beograd
- » Ivanoviç kërçenon!

Lajmet e ditës

Të fundit Më të rekomanduarat +

- » Serbia nuk do t'i njohë vulet e Republikës së Kosovës
- » Westerelle: Statusi i dhe kufijtë, çështje të mbyllura
- » Për një të ardhme të fuqishme
- » Shumë prizrenas heqin dorë nga shtetësia e Kosovës
- » Autostrada e parë vetëm në hartë
- » Riatdhesimi i dhimbshëm
- » Buhler i përgjigjet Brigitte Bardot
- » EULEX, pajiset me 6 autoblinda
- » Vlasi: Ndaja nuk është opsjon real
- » Lunacek: S'mjafton Miladiqi për BE
- » Konsullata, nga 1 qershor i lëshojnë dokumente personale
- » Vija e kuqe, nuk diskutohet!
- » Rugovasit për Qeverinë: Pa ne mos flitni për kufirin
- » Shqipja në Beograd
- » Ivanoviç kërçenon!

OPINIONE



Dalja e LDK-së nga hija
Adrian Çollaku

Revolutioni i papërfunduar i Egjiptit
Qemal Morina

Nga Ditari: Kadare!
Beqë Cufaj

Gjërat pa të cilat	Turpi i "Marigonës"	Mbi 80% e popullatës janë proserbë*
(s)mund të jetonil (4)	(55)	(46)